REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 55/17
Datë/Datum. 27.04.2017

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 55/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje Tefik Sylejmani – Kryetar,duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 55/17, të parashtruar nga operatorët ekonomik"PBC"me seli në Prishtinë,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"me nr. të prokurimit 2017/001/236, të shpallur nga autoriteti kontraktues–KRU Hidromorava sh.a. në seancën e dt. 12.04.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "PBC"me seli në Prishtinë,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"me nr. të prokurimit 2017/001/236, të shpallur nga autoriteti kontraktues–KRU Hidromorava sh.a.

II. **Obligohet,** autoriteti kontraktues KUR Hidromorava sh.a. të bëjë përmirësimet në dosjen e tenderit në pajtim me nenin 53.7 të LPP-ës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"me nr. të prokurimit 2017/001/236.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues "PBC"me seli në Prishtinë konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifat e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

AK-KUR Hidromorava sh.a. ka publikuar njoftimin për kontratë me titull "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në automjete"me nr. të prokurimit 2017/001/236, procedurë e hapur , kontratë për shërbime, vlera e vogël.

Kriter për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Afati i fundit për ofertim ka qenë 21.02.2016,gjatë fazës tenderuese OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit bënë ankesë duke mos u pajtuar me specifikat teknike me pretendim se AK-KUR Hidromorava ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 me rastin e hartimit të dosjesë së tenderit dhe specifikimit teknik .

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues z.Fazliun dhe ekspertin teknik z.Hasanin për trajtimin e pretendimeve ankimore, të cilët kan dhen mendimin e tij dhe ka rekomanduar që të aprovohet pjesërisht ankesa e OE ankues dhe AK të bëjë përmirësime në DT lidhur me postimin e platformës të GPS sistemit.

AK përmes parashtresës me shkrim nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit , ndërsa OE-të ankues po ashtu përmes parashtresës me shkrim janë pajtuar pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe teknik.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 12.04.2017, ku të pranishëm ishin përfaqësuesi i OE ankues,përfaqësuesi i AK dhe eksperti shqyrtues dhe ai teknik paneli shqyrtues shqyrtoi shkresat e lëndës si:dosjen e tenderit me specifikime teknike,ankesën e OE ankues,raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues dhe teknik si dhe përgjigjet e palëve lidhur me këtë raport e po ashtu bëri edhe dëgjimin e palëve ku në fillim fjala ju dha përfaqësuesit të OE ankues "PBC" z.Prelvukaj i cili deklaroi: "AK sipas nesh ka përpiluar specifikat teknike që nuk sigurojnë qasje të barabartë pasi ka kërkuar që qendra e të dhënave të vendoset në një shtet anëtar të BE , duke vazhduar me kërkesë që pajisja të ketë protokoll të veçanta FSM (ky është protokolli i veçanta), e që këtë protokolle ka kompania kroate Smart Ivo, dhe kështu supozojmë se ka bërë shkelje të par.2 nenit 7 të LPP-së.

Ka kompani që kanë këtë protokoll, mirëpo nëse merren gjitha kërkesat i i përshtaten Smartivvo.

AK ka shkel pikat i, iii të par.6 neni 7 duke përpiluar kritere që limitojnë dhe ose diskriminojnë OE, me kërkesë që OE të ketë ISO certifikatë.

Supozojmë se AK ka cenuar par.2 nenit 28 pasi që nuk ka përpilua specifika teknike në mënyrë që të jetë në përputhje me qëllimin e projektit, duke kërkuar që aplikacioni të shkarkohet vetëm nga

dyqanet elektronike App Store dhe Google Play, e që përsëri këto kërkesa përgjeigjen kompanisë Smartiovo.

Me datë 20.03.2017 kemi marr ekspertizën nga z.Fazliu dhe z.Hasani si ekspert teknik, të cilët konform nenit 113 pika.1 kanë sjell ekspertizën për lëndën nr.55/17.

Ne jemi pajtuar pjesërisht në raportin e ekspertizës pasi kanë cekur edhe ekspertët se është shkelje të që baza të jet në një shtet anëtar të BE-së.

Mirëpo nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit ku përmenden tre prodhues të GPS pajisjeve që kanë FSM protokoll. Kjo është e vërtetë që kanë FSM protokoll mirëpo nuk plotësojnë kushtet tjera teknike.

Eksperti teknik është koncentruar vetëm në kërkesën për FSM protokoll duke injoruar kërkesat tjera, dhe me vetë këtë fakt ne do ishim diksulifikohemi.

Në pikën e radhës ku nuk pajtohemi me ekspertin teknik, është ku jep mendim për tre prodhues të aplikacioneve të cilët aplikacionin e tyre e lejojnë të shkarkohet përmes google play dhe app store, por që nuk kanë ISO certifikatë, kështu që prapë do janë të papërgjegjshëm.

Nga tre prodhuesit e propozuar nga eksperti kam kërkuar me shkrim të vërtetojnë nëse kanë ISO certifikatë, dhe kam marr përgjigje negative, kopje të cilave ja ofroj panelit shqyrtues dhe të pranishmëve.Nga kjo që u tha kërkojmë nga paneli të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën tonë.

Në vazhdim fjala iu dha përfaq1ësuesit të AK-KRU Hidromorava z.Idrizi i cili deklaroj:

Pretendimi për postim siç ka konstatuar eksperti se qëndron pjesërisht, ne kemi pas GPS kinezes dhe jemi detyruar të ndërrojmë ato me vende nga Evropa , pasi produktet nga kina kanë dështuar për kohë shumë të shkurtë.

Un në konsultim me inxhinierët kam marr konfrimin se ka më shumë se tri kompani që plotësojnë kushtet sipas dosjes së tenderit.

Sido që të jetë ne do respektojmë vendimin e panelit shqyrtues, mirëpo duhet të cek se kjo ankesë është vetëm vonesë për zhvillim të procedurave të këtij prokurimi.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Fazliu i cili deklaroj:Pretendimi ankimorë për çështjen e hostimit – bazën e të dhënave, kjo nuk lejohet me ligj që të kufizoj vendim në bazë të territorit.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Hasani i cili deklaroj:Mendoj se AK pak a shumë me drejtë ka kërkuar që hostimit të behet në vende të BE-së për shkak frikës së mallrave kineze siç ceku më herët.Si do që të jetë AK me këtë ka diskriminuar vendet tjera sa i përket qendrës.

Për dy pikat tjera qëndroj pranë ekspertizës së dhënë për këtë lëndë.

Sa i përket ISO certifikatës, kjo është certifikatë që mbikëqyr procesin e zhvillimit të projektit dhe për tu siguruar që procesi dhe zhvillimi projektit do shkoj në rregull atëherë AK ka kërkuar ISO certifikatë. Kjo certifikatë dëshmoj proceset e punës hap pas hapi derisa të kryhet projekti, është metodologji e punës.

Sa i përket FMS (Fleat Menagment Sysytem) është një standard i dizajnuar që përdor Interface FMS apo lidhjen e cila shërben për transferimin e të dhënave, dhe ka kompani tjera që e ofrojnë FMS standardin. Disa prej tyre i kemi cek edhe në raportin e ekspertizës.

ISO certifikata dhe pajisja Falcom janë dy procese të ndryshme.ISO certifikata është metodologji e punës që e kanë kërkuar AK.Edhe prodhuesi Falcon prodhon GPS.

AK ka kërkuar që gjatë implementimin të projektit të përdoren standardet ISO si metodologji e punës.

Sa i përket pikës ankimore nr.3, është kërkuar që sistemi ISO të shkarkohet nga App Store dhe Google Play, të cilat janë të vetmet dyqane elektronike të aplikacioneve mobile, dhe këtë me qëllim që të ruaj origjinalitetin e vet.Për këtë mendoj se AK ka të drejtë pasi ka prodhues tjerë të GPSD-ve që sistemet e tyre i ofrojnë në aplikacione mobile.

Qëndrojmë pranë raportit të ekspertizës.

Anëtari i panelit pyeti ekspertin se a është kërkuar nga OE që ofron në tender apo nga prodhuesi i pajisjeve certifikata ISO.

Në përgjigje z.Hasani deklaroj:Kërkesa ka qenë që OE duhet të ketë ISO certifikatë për veprimtari të ngjashme.

Në vazhdim z.Prelvukaj deklaroj:

Mendoj se nuk u sqaruar mjaft çështja e ISO certifikatës, AK ka kërkuar ISO 27001 e cila është për sigurinë e të dhënave.

Këtë certifikatë e ka vetëm IPKO dhe Vala në Kosovë.

Në fund z.Hasani deklaroj:

Sa i përket interface ka prodhues tjerë që kanë këtë pajisje, dhe kjo ka qenë pretendim ankimorë se nuk ka prodhues tjerë, dhe si ekspert kemi dëshmuar të kundërtën.

Në fund përfaqësuesi i AK z.Idrizi deklaroj:

Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK si të bazuar.

Paneli shqyrtues konfirmoi se **në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket** kërkesës së FDT-së lidhur me atë se vetëm në shtetet e BE-së të bëhet hostimi i platëformës të GPS sistemit, qëndron ky pretendim ankimor sepse AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-ës duke bërë kufizim që postimi i platformës të GPS të bëhet vetëm në shtete të BE duke përjashtuar të tjerët.

Lidhur me pretendimet e OE ankues për specifikimet teknike se Ak ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 të Ligjit 04/L-042 të LPP, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,nuk qëndrojnë sepse është e drejtë e AK-së të përpiloj specifikacionin teknik në atë mënyrë që siguron zhvillimin dhe përfundimin të suksesshëm të projektit pasi që kemi të bëjmë më shërbim profesional, në rastin konkret autorizimi nga prodhuesi dhe certifikata ISO, janë kërkesa për shërbim profesional të cilat nuk diskriminojn apo favorizojnë ndonjë nga OE të interesuar për pjesëmarrje pasi që janë kritere që vlejnë për të gjithë.

Pretendimi i OE se AK ka favorizuar një prodhues të caktuar dhe atë kompanin "Smartivo" të cilën OE ankues ju ka refereruar se AK-ja ka favorizuar, nuk qëndron për faktin se ekzistojnë dhe prodhues të tjerë të cilët prodhojnë këtë lloj pajisje dhe kjo u konfirmua edhe gjatë seancës dëgjimore nga eksperti teknik i cili deklaroi se ka edhe disa prodhues tjerë lidhur me këto pajisje.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si: dosjen e tenderit me specifikime teknike,ankesën e OE,raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues,përgjigjet nga ana e AK dhe OE ankues lidhur me këtë raport të ekspertizës si dhe dëgjimin e palëve paneli gjeti se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe i rekomandon që të shtyj afatin e dorëzimit të ofertave konform nenit 53 të LPP-ës dhe të njoftoj të gjithë OE të cilët kanë tërhequr DT.

Andaj paneli shqyrtues nga provat e cekuar më lartë ,në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshill juridike:

Kundër këtij vendim nuk është e

lejuar ankesa. Palë e pakënaqura
kundër këtij vendimi mund të ushtrojnë
kërkesë-padi për kompensim dëmi në

Gjykatën Themelore Departamenti Administrativ

në afat prej 30 ditësh.

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES
Tefik Sylejmani